

## Në këtë numër:

Arritje të pjesmarrësve gjatë  
 zgjedhjeve të 12 tetorit

faqe 2

Vizitë studimore në Bullgari

faqe 3

Projekti: "Rritja e Pjesmarrjes së Gruas në Vendimmarrje"  
 Njohja me Sistemin: "Një Anëtar Një Votë"

faqe 10

### Si më ndihmuan njohuritë e NDI në suksesin tim

Mimoza Hasekui, pjesmarrëse e programit të NDI, ishte Kryetaria e shtabit fitues të zgjedhjeve për Bashkinë e Elbasanit. Ajo shprehet se "Njohuritë e marra nga programi i NDI, ishin vendimtare në arritjen e fitores së Kandidatit të PD për Kryebashkiakun e Elbasanit. Dhe puna ime e filluar me organizimin e një trainimi për të gjithë kandidatët e partisë sime në Elbasan i dha frytet e saj në mënyrë të mrekullueshme."





## Urime Taulant!

Pjesmarrësi i programit të NDI mbi Menaxhimin Politik, Taulant Balla (foto majtas) emërohet këshilltar politik në kabinetin e zëvendës kryeministres së Shqipërisë znj Ermelinda Meksi.

## PD - Trainime në Rrëshen

Gjergj Marku (foto djathtas) dhe Gjon Pjetri, kanë organizuar gjatë periudhës parazgjedhore disa seminare të veçantë me kryesitë dhe anëtarët e degëve të ndryshme të PD në rrethin e Rrëshenit. Temat e trajtuara përfshinin "Hartimin e strategjive fituese", "Ndërtimin e Mesazhit" dhe "Kontaktin me Votuesit".



## Trainime të PS në Tiranë

Elvis Mataj dhe England Cacaj (foto djathtas) ishin organizatorët e tre trainimeve të zhvilluara gjatë muajit shtator me tre këshilla zonale të PS në Tiranë. Këto trainime u fokusuan në organizimin e fushatës elektorale, menaxhimin e ditës së votimit dhe në njohjen e rolit të menaxherit të degës së partisë. Të 140 pjesmarrësit në këto trajnime i vlerësuan ato si shumë të dobishme në punën e tyre.

Elvis Mataj dhe England Cacaj (foto djathtas) ishin organizatorët e tre trainimeve të zhvilluara gjatë muajit shtator me tre këshilla zonale të PS në Tiranë. Këto trainime u fokusuan në organizimin e fushatës elektorale, menaxhimin e ditës së votimit dhe në njohjen e rolit të menaxherit të degës së partisë. Të 140 pjesmarrësit në këto trajnime i vlerësuan ato si shumë të dobishme në punën e tyre.

## Në media

**Antoneta Malja** (foto djathtas) në artikullin e saj "Janë burri apo gruaja të diskriminuar?" të datës 16 korrik në gazetën Rilindja Demokratike pasqyron realitetin e pjesëmarrjes së gruas në të gjithë fushat e jetës duke sjellë statistika të përfaqësimit në pushtetin qendror, lokal, gjyqësor etj. Ajo përpiket të sensibilisojë lexuesit për nevojën e një roli më të madh të grave në politikë.



**Reiz Mulita** në artikullin e tij të datës 17 korrik në gazetën Shekulli "Zgjedhjet dhe përgjegjësia e politikanëve" thekson se politikanët nuk kanë krijuar tregues efektivë për të matur cilësinë e atyre që duan të kandidojnë në zgjedhje dhe as nuk kanë vendosur kriteret për të matur arritjet e atyre që janë zgjedhur dhe u është dashur të zbatojnë programet politike.

**Taulant Balla** (foto djathtas) në artikullin e tij të datës 8 tetor në gazetën Shekulli, përshkruan me ngjyra të gjalla konferencën e Partisë Laboriste Britanike të cilën ai e ndoqi si i ftuar. Ai ngre një paralelizëm mes laboristëve anglezë dhe socialistëve në Shqipëri, duke theksuar si pikë të përbashkët debatin e brendshëm, i cili ka ndihmuar në forcimin e demokracisë partiake dhe në formulimin më të mirë të politikave.



**Elvis Mataj** (foto majtas) në artikullin e tij të datës 15 korrik në gazetën Koha Jonë, me titull "Rreziku i monopoleve në ekonominë shqiptare", argumenton krijimin e monopoleve nëpërmjet arbitraritetit të administratës taksambledhëse, ku kompanitë e mëdha me mbështetje politike paguajnë më pak taksë se ato të mesme dhe të vogla. Prandaj, qeveria duhet t'i adresohet këtij problemi për të rritur besueshmërinë e vet në prag të zgjedhjeve lokale.

# Lajme të reja Zgjedhjet lokale 2003:

Gjatë zgjedhjeve të 12 Tetorit për qeverisjen lokale pjesmarrësit e programit të NDI mbi Menaxhimin Politik morën pjesë aktive si kandidatë apo si menaxherë të shtabeve elektorale të partive të tyre. Më poshtë po prezantojmë disa rezultate paraprake, ende të pazyrta, që ata kanë arritur.

Nga Pjesmarrësit e programit të tanishëm: **Mimoza Hasekiu** arriti sukses si kryetare e shtabit elektorale që i solla PD-së fitoren e bashkisë, Elbasan; **Artur Kurti** (foto poshtë, majtas), zgjidhet Kryetar i Bashkisë Kuçovë; **Agron Sula** (foto poshtë, djathtas), zgjidhet Kryetar i Komunës Balldashk, Tiranë; **Etleva Bisha**, zgjidhet anëtare e Këshillit Bashkiak, Tiranë; **Voltana Ademi**, zgjidhet anëtare e Këshillit Bashkiak, Shkodër; **Klodian Pajuni**, anëtar i Këshillit Bashkiak, Durrës; **Delina Korbi** zgjidhet anëtare e Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr 10, Tiranë; **Altin Qoshja**, zgjidhet anëtar i Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr 1, Tiranë; **England Cacaj**, zgjidhet anëtar i Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr 5, Tiranë; **Mark Lleshi**, zgjidhet anëtar në këshillin e Komunes Orosh, Mirditë; **Suela Morina**, zgjidhet anëtare e Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr 4, Tiranë; **Edvin Zoto**, zgjidhet anëtar i Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr 10, Tiranë; **Merita Myftari**, zgjidhet anëtare e Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr 1, Tiranë; **Gjon Pjetri** dhe **Gjergj Marku** arritën sukses si menaxherë të fushatave të PD në fitoren e bashkive të Rubikut dhe Rrëshenit.

Nga pjesmarrësit e programit të mëpërparshëm ZHUP: **Ferdi Sërkaçaj**, zgjidhet Kryetar i Komunës Shkrel, Malësi e Madhe; **Eva Allushaj**, rizgjidhet anëtare e Këshillit Bashkiak, Tiranë; **Gjergji Mano**, rizgjidhet anëtar i këshillit Bashkiak, Sarandë; **Anila Nanushi**, rizgjidhet anëtare e Këshillit Bashkiak, Kuçovë; **Ylli Subashi**, zgjidhet anëtar i këshillit bashkiak në Vorë, Tiranë.



# Vizita Studimore në Bullgari

Në sajë të mbështetjes së World Learning, e financuar nga USAID, 12 pjesmarrëse të programit më të ri të NDI patën mundësinë për t'u njohur me disa nga dukuritë e jetës politike të grave bullgare. Përgjatë një jave të Qershorit që kaloi, pjesmarrëset nga Shqipëria u pritën nga personalitete të politikës bullgare si deputete, profesore, kryetare bashkish, nga përfaqësuese të OJQ-ve, gazetarë, etj. Gjatë kësaj vizite, pjesëmarrëset shqiptare krijuan një vizion të qartë të hapave që duhen hedhur për të arritur në



një emancipim politik, ku grave do t'u jepej mundësia për të qenë të barabarta me burrat në marrjen e përgjegjësiave politike dhe udhëheqëse. Ato mësuan se sot, Parlamenti bullgar ka 63 anëtare gra, që përbën 25.42% të tij - një hap i madh po të krahasohet qoftë edhe me përfaqësimin e gruas në vitin 2001 i cili ishte vetëm 17 anëtare. Për Shqipërinë nuk është vonë për të filluar një lëvizje që do t'i jepte femrës shqiptare pozicionin që meriton në shoqëri dhe politikë.

Kjo vizitë studimore në Bullgari u shërbeu pjesmarrëseve për të filluar një projekt, i cili ka gjetur mbështetjen financiare të USAID-it dhe është duke u zhvilluar me shumë sukses. Kjo nismë ka për qëllim shtimin e mbështetjes për gratë shqiptare, të cilat kanë aspirata në fushën e politikës.

## Projekti: Rritja e pjesmarrjes së gruas në procesin e vendimarrjes

Programi i titulluar "Rritja e pjesmarrjes së gruas në procesin e vendimarrjes dhe përmirësimi i aftësi të tyre vendimmarrëse" e pati fillimin e tij me idenë që i'u lindi 12 pjesmarrëseve të programit të NDI, menjëherë pas kthimit të tyre nga një vizitë studimore në Bullgari. Ato e hodhën idenë në letër dhe, duke pasur ndihmën e plotë zyrës së NDI, kjo ide u shndërrua në një projekt të vërtetë, të detajuar i cili i'u paraqit World Learning për mbështetje dhe më pas USAID-it për financim. Tani, disa ditë pas përfundimit të fazës së parë të projektit, rezultatet janë vërtet ngazëllyese. Të 12 trainueset, Arta Sakja, Liljana Mera, Alma Lahe, Merita Myftari, Xhuljeta Jaho, Anuela Kondi, Antoneta Malja, Nevila Bejleri, Mimoza Hysaj, Suela Morina, Xhuljeta Kërtusha dhe Delina Korbi organizuan në 12 qarqet seminare njëditore trainuese për gratë (rreth 500) kandidate për kryetare apo këshilltare të njësisë vendore, përfaqësuese të forcave të ndryshme politike.



## Opinione për NDI



**Gjergj Marku**  
Nëpërmjet programit të NDI, gjithçka merr vlerë.



**Roland Beleri**  
Programi është shumë pozitiv, veçanërisht për partitë e vogla. Koha që kalojmë në këtë program është me shumë vlera për ne.



**Anila Osmani**  
NDI është jo vetëm një shkollë menazhimi, por edhe një hap më shumë për karrierën e suksesshme të politikanëve të rinj.

# Projekti: Së bashku drejtojmë më mirë

Merita Myftari pjesmarrëse e programit të NDI, ishte trainuesja në seminarin e zhvilluar në datat 12 dhe 13 Korrik qytetin e Peshkopisë, në kuadrin e projektit “Së bashku drejtojmë më mirë” organizuar nga shoqata MEDIALB – Për të drejtat e gruas, e mbështetur financiarisht nga fondacioni Sorros. 24 pjesmarrëset në trainim, të cilat vinin nga politika, administrata dhe shoqëria civile u njohën me çështje të rritjes së pranisë së grave në përfaqësim politik dhe vendimmarrje.



## Projekti: Gruaja në Udhëheqje

Xhuljeta Jaho, Liljana Mera (foto majtas), Mimoza Hasekiu, Voltana Ademi dhe Miranda Çerepi ishin pesë prej pjesmarrësve të programit të NDI që shërbyen si lektore në një numër seminaresh, pjesë të projektit “Gruaja në Udhëheqje” organizuar nga UNDP Albania dhe bashkëfinancuar nga SIDA. Ky projekt kishte si qëllim rritjen e kapaciteteve të grave në prag të fushatës elektorale për zgjedhjet e pushtetit lokal. Një seri e plotë seminaresh u zhvilluan në të gjitha qytetet e Shqipërisë me pjesmarrjen e 656 grave, që vinin nga parti të të gjithë spektrit politik shqiptar.

## Republikanët në trainime mbi fushatën elektorale



Pjesmarrësi republikan në kursin e NDI, Edvin Zoto organizoi në datën 2 Gusht dy trainime të veganta në qytetet e Rreshenit dhe Krujës me 31 anëtarë të partisë republikane të këtyre degëve. Temat e trajtuara në këto trainime kishin të bënin me aktivitetet të cilat një degë partie duhet të kryejë gjatë fushatës elektorale si psh kontakti me votuesit, marëdhënie me median dhe prodhimi i materialeve propagandistike të partisë.



## Trainime me anëtarët e partisë Balli Kombëtar

Në datën 11 Gusht, Desdemona Gaba (foto majtas) dhe Florian Xhuti organizuan trainimin e tyre të radhës, kësaj here me anëtarë të forumit rinor të Partisë së Ballit Kombëtar në qytetin e Tiranës. 20 pjesmarrësit në këtë trainim fituan njohuri në lidhje me mënyrat për të nxitur pjesmarrjen rinore në zgjedhje si dhe mbi teknikat e kontaktit me votuesin.



## Trainime të PBDNJ

Në kuadër të projekteve individuale pranë programit politik të NDI, Alma Lahe dhe Majlinda Barka, kohët e fundit kanë organizuar një sërë trainimesh me degë lokale të PBDNJ në të gjithë Shqipërinë. Duke qenë se kjo periudhë përkoj edhe me përgatitjen e fushatës elektorale për zgjedhjet vendore të 12 Tetorit 2003, temat kryesore të trajnimeve ishin: “Elementët e një fushate të suksesshme”, “Ndërtimi i mesazhit”, “Dita e zgjedhjeve”, etj.





### Trainime me FRPD, Durrës

Rovena Muzhaqi organizoi dy trainime të veçanta gjatë muajit shtator me degën e Forumit Rinor të PD, Durrës. Temat e trajtuara në këto trainime ishin: Kontakti me Votuesin, Organizimi i Sondazheve dhe Menaxhimi i Ditës së Votimit. Gjatë trainimit të dytë ishte ftuar edhe Kryetari i FRPD, Z. Sokol Olldashi dhe kolegët e tjerë të Rovenës, pjestarë të programit të NDI mbi Menaxhimin Politik nga qyteti i Durrësit.

## Opinione për NDI



### Gjon Pjetri

Programi i Menaxhimit politik të NDI është investimi më frytdhënës për formimin e klasës së re politike me mentalitet të ndryshëm nga ai i derisotëm.



### Suela Morina

Programi po edukon një brez të ri politikanësh të denjë për të ardhmen e politikës shqiptare.



### Miranda Çerepi

Ky program ka përmirësuar ndjeshëm jo vetëm formimin tim teorik, por edhe atë praktik.

## Trainime të Demokratëve të Rinj

Miranda Çerepi dhe Roland Beleri, përfaqësues të PDr në programin e NDI kanë organizuar gjatë muajve Gusht dhe Shtator disa seminare trainuese me strukturat drejtuese dhe anëtarët e PDr në Tiranë dhe në Durrës duke bashkëpunuar me "Akademia Politike", një organizëm trainues pranë PDr. Temat qendrore të këtyre trainimeve ishin "Hartimi i platformës elektorale", "Ndërtimi i mesazhit të partisë".



## Trainime të PS në Berat dhe Kuçovë



Në datën 17 Korrik, Arjan Kokoshi organizoi dy trainime me të rinjtë socialistë në Berat dhe Kuçovë. 41 pjesmarrësit e rinj socialistë morën trainim në temat "Zhvillimi i Mesazhit", "Rritja e Pjesmarrjes rinore", "Sistemi një anëtar një Votë" etj. Përveç trainimeve me të rinjtë socialistë, Arjani organizoi gjithashtu edhe një trainim tjetër me kryesinë degës së PS Kuçovë, ku të 11 pjesmarrësve i'u shtjelluan temat "Zhvillimi i mesazhit të një partie" dhe "Sistemi Një Anëtar Një Votë".



### Demokristianët në rrugën e trainimeve

Atlie Cani dhe Nikolin Kurti organizuan gjatë muajit Gusht dhe Shtator gjashtë trainime të veçanta në qytetin e Tiranës në lidhje me mirorganizimin e një fushate elektorale. Temat që u mbuluan në trainimet e tyre ishin "Kontakti me votuesin", "Marëdhëniet me median" dhe "Fushata në zonat rurale". Numri i të trainuarve në total ishte rreth 240 vetë.



## Trainime të legalistëve

Blerim Kamberi, përfaqësues i PLL në programin e NDI mbi Menaxhimin Politik trainoi një grup anëtarësh të Forumit Kombëtar të Rinisë Legaliste. Temat kryesore që u trajtuan ishin "Çfarë përfaqësojnë të rinjtë", "Arsyet dhe rrugët për angazhimin e të rinjve", "Çfarë e pengon pjesëmarrjen e të rinjve" dhe "Avantazhet e pjesëmarrjes rinore". Gjithashtu, gjatë muajve gusht dhe shtator, Blerimi organizoi tre trainime të tjera me kandidatët për këshilltarë të PLL në Tiranë si dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore të partisë së tij në Sarandë dhe Tiranë.





## Më tepër njohuri nga eksperiencat perëndimore

Gjatë një vizite studimore në Mbretërinë e Bashkuar, përfaqësuesi i Programit për Zhvillimin e Partive Politike të NDI, z. Guri Daco, pati rastin të shihte nga afër mënyrat me të cilat degët lokale të partive angleze organizonin punën për të mbajtur një anëtarësi sa më aktive dhe se si ato përpiqeshin për të ngritur profilin e tyre në komunitet. Gjithashtu një përvojë interesante e përfutur gjatë kësaj vizite ishte njohja me funksionimet e këshillave të qeverisjes lokale, zyrtare lokale të deputetëve, zyrtare të shtypit dhe të prodhimit të materialeve propagandistikë si dhe organizimi i fushatave për kontaktin “derë më derë” me votuesit. Materialet ilustruese të këtyre eksperiencave britanike tani ndodhen në bibliotekën e NDI për t’u përdorur nga të gjithë pjesmarrësit.

## Arritje të pjesmarrësve të ZHUP

Në vazhdim të rubrikës së hapur në numrin e kaluar të revistës, kësaj here po publikojmë proflet e katër ish-pjesmarrësve në ZHUP III, të programit të NDI për Partitë Politike në Shqipëri.



**Nexhmi Torra, PDK**  
Menaxher i fushatave për tre zona.  
Organizator i një trainimi në nivel rajonal për përfaqësuesit e partisë së tij në komisionet zgjedhore.  
Ngriti degën e PDK në Devoll, e cila numëron 40 anëtarë aktivë.



**Ferdi Sterkaj, PD**  
Zgjidhet Kryetar i Komunës Shkrel (Malësi e Madhe).  
Kryetar i PD, Malësi e Madhe.  
Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të PD.



**Anila Nanushi, PS**  
Kryetare e Këshillit Bashkiak, Kuçovë.  
Anëtare e Kryesisë së PS Kuçovë.  
Anëtare e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë



**Gjergj Mano, PS**  
Rizgjidhet kryetar i FRESSH, dega Sarandë.  
Rigjidhet anëtar i Këshillit Bashkiak Sarandë.  
Anëtar i komitetit të përgjithshëm drejtues të FRESSH

## Konsulentët takohen me pjesmarrësit e rinj

Në vazhdim të takimit të parë që u organizua me pjesmarrësit e programeve të mëparshme të NDI, në rolin e tyre si konsulentë të pjesëmarrësve në programin aktual, në 13 Maj, në zyrat e NDI, u zhvillua një takim prezantues i këtyre të fundit me pjesmarrësit e rinj me të cilët ata do të bashkëpunojnë. Të dy palët premtuan bashkëpunim për të realizuar me sa më shumë sukses nismat trainuese brenda forcave të tyre politike respektive.



## Etika në qeverisje

Një libër i ri, i quajtur “Etika në Qeverisje”, pritet t’u paraqitet së shpejti lexuesve shqiptarë. Libri është shkruar nga Prof. Richard Chapman, një autor i mirënjohur botëror i çështjeve të etikës dhe korrupsionit. NDI po koordinon përpjekjet për publikimin e këtij libri në gjuhën shqipe. Botimi i librit sponsorizohet nga Ambasada Amerikane në Tiranë dhe mbështetet nga MSI dhe URI. Prof. Chapman do të vizitojë Shqipërinë në mesin e muajt nëntor për të bërë prezantimin e librit dhe gjithashtu për të dhënë një seri leksionesh mbi çështjet e etikës në qeverisje.



## Shkolla Trainuese mbi Fushatat Mediatike

Në datën 5 Korrik, NDI organizoi shkollën e tretë trainuese njëditore me tematikë “Media, politika dhe fushatat mediatike”. Aktiviteti u hap nga z. Eric Richardson — përfaqësuesi i USAID (donator i projektit të NDI). Dy lektorët, Jonathon Carr Brown, gazetar i The Sunday Times dhe Sharon Holden, ish gazetare e BBC World Service, paraqitën mënyrat e hartimit dhe të prezantimit të një deklaratë shtypi “perfekte”, teknikat më efektive të dhënies së intervistave radiofonike apo televizive, mënyrat e komunikimit me gazetarët, teknikat e “të bërit për vete” të politikave të brendshme të mediave, kur dhe si duhet të pranosh dhe të mohosh, etj.

# Alternativa Juaj

**Nga Jennifer L. Butz**  
Drejtoreshë e Zyrës Vendore dhe e  
Programit Forumi Civil

Qytetarët janë apatikë.  
Qytetarët nuk e kuptojnë  
politikën. Qytetarët nuk votojnë.  
Deklarata më se të zakonshme,  
por jo të vërteta.

Disa qytetarë ndërmarin  
veprime. Disa qytetarë duan  
që politikanët t'i drejtohen  
prioriteteve dhe shqetësimeve  
të tyre në mënyrë realiste. Së fundi, qytetarët kanë kërkuar kohën dhe vëmendjen e kandidatit — me sukses modest. Shumë prej politikanëve ende u thonë “jo” ftesave të qytetarëve.

Në tetor, qytetarët në dymbëdhjetë komunitete ftuan kandidatët për postin e kryetarit të bashkisë/komunës nga gjashtë parti politike, për të debatuar me kundërshtarët e tyre. Katër komunitete e realizuan këtë lloj debati: Sineballaj dhe Lekaj në Kavajë; Bërxullë dhe Baldushk në Tiranë. Kur kandidatët thanë “po” më shumë se 150 qytetarë erdhën për të dëgjuar përgjigje të thelluara për pyetjet e tyre. Kandidatët që u paraqitën kishin përgatitur përgjigje për pyetje të paracaktuara mbi platformat, vizionet dhe kualifikimin e lidershit. Qytetarë drejtues të debatit i kërkuan kandidatëve që të respektonin rregullat e diskutimit si dhe kohën e caktuar për secilën nga përgjigjet, dhe kështu u bë.

Pavarësisht nga përpjekjet e shumta të qytetarëve në Synej dhe Gosë (Kavajë); Shijak, Manëz, Sukth, Maminas dhe Rashbull (Durrës); dhe Bathore (Tiranë), një numër i pamjaftueshëm kandidatësh ranë dakord



për të diskutuar çështjet në publik. Kandidatë të majtë dhe të djathtë e refuzuan ftesën e qytetarëve në mënyrë të barabartë. Justifikimet për mospjesmarrje varionin që nga mosdashja për të qenë në të njëjtën sallë si kundërshtarë e deri tek diagnozat mjeksore që përjashtonin pjesmarrjen në debat, por jo, siç mund të merret me mend, streset e tjera që ka gara për këtë post.

Tre vjet më parë, kur qytetarët e programit të Forumit Civil ftuan kandidatët për të folur, as edhe një politikan nuk u duk. Rezultatet e këtij viti paraqesin një hap përpara. Kjo fitore i takon qytetarëve që morën nismën dhe që bënë të mundur një debat rigoroz dhe të shëndoshë përpara se të jepnin votën e tyre në zgjedhjet vendore. Kjo zgjedhje është gjithnjë e më shumë e rëndësishme në jetën e përditshme ndërsa procesi i decentralizimit sjell përgjegjësi gjithnjë e më të mëdha për funksionarët vendorë.

2005-sa është shumë pranë. Shpresojmë që deputetët po i vënë veshin ndërgjegjësimit dhe veprimtarisë në rritje të qytetarëve. Kurse për ata që do të fitojnë funksionet vendore në zgjedhjet e 12 Tetorit, qytetarët, përsëri, do të shohin me vëmendje çfarë do bëhet dhe se çfarë nuk do të bëhet.



## Opinione për NDI



**Tonin Çefa**  
Ky programi erdhi në kohën  
e duhur dhe do të mbahet  
mend si shkolla e parë  
politike në Shqipëri.



**Laert Duraj**  
Në programin e NDI  
shkrihet pasioni me  
profesionin, duke i ofruar  
në këtë mënyrë një vizion  
të qartë për të ardhmen  
çdo politikani të ri që ndjek  
këtë program.



**Alma Lahe**  
Programet e NDI na kanë  
mësuar se politika nuk  
është një hobi, por është  
një profesion që ka ligjësitë  
dhe rregullat e veta.

# Për një politikë ndryshe

Nga Etleva Bisha



Pothuaj pesë shekuj iu deshën shteteve të Evropës Perëndimore për të kapërcyer dobësitë e tyre, për të përmirësuar defektet dhe për të ndërtuar, në fund të fundit, sisteme demokratike. Nëse i referohemi këtij harku kohor perspektiva nuk duket e keqe për ne shqiptarët që tashmë prej 13 vitesh flasim pa fund për një sistem të vërtetë demokratik pas një izolimi tepër të gjatë. Por ne, ashtu si edhe vende të tjera me demokraci të brishtë nuk mund të kemi luksin

e zgjatjes së eksperiencës traumatike dhe të kushtueshme qindrvjeçare të shtetbërjes së Evropës. Alternativat tona janë vetëm dy: Të arrijmë synimin tonë brenda një kohe fare të shkurtër ose të mbetemi në periferinë e sistemit të shteteve me demokraci të konsoliduar. Politikëbërësit shqiptarë janë padyshim nën presionin e nevojës për të ndërtuar një shtet demokratik menjëherë, të kryejnë detyrën e shtetbërësit sipas stilit njerëzor, të civilizuar e konsensual, dhe gjitha kjo në epokën e politikës masive. E vështirë, por jo e pamundur! 13 vjet nuk janë pak dhe ajo që më shqetëson më shumë është që ndoshta nuk e kemi përdorur si duhet gjithë këtë kohë për të shkuar

atje ku të gjithë shqiptarët dëshirojnë. Nuk dua të jem pesimiste, por më duket se politika shqiptare në gjithë këta vjet më shumë se sa progresin e ngadalshëm u ka injektuar shqiptarëve një dozë pesimizmi të pamerituar. Pa dashur të bëj teori për të shpjeguar "pse"-në e kësaj mungese besimi dhe këtij pesimizmi, dua t'ju kujtoj një prej përkufizimeve mbi demokracinë: "Demokracia është një sistem i qeverisjes që i zgjidh konfliktet në institucione të tilla, si Parlament apo Gjykata dhe jo në fushën e betejës". A ndodh kështu në Shqipëri? Në sa e sa raste vetë Parlamenti ka marrë pamjen e një fushe beteje mes politikanësh? E, pra, a kemi të drejtë kur jemi pesimistë me politikanët tanë, që ende nuk e njohin thelbin e demokracisë? Besoj se PO!

## Profil Sa të integruar e gjejnë veten pjesmarrësit e programit në forcat politike përkatëse



Pjesmarrësit e Partisë Demokratike të Re në programin mbi Menaxhimin Politik, znj. Miranda Çeripi (foto djathtas), e cila është momentalisht Kryetare e PDR për qytetin e Durrësit dhe z. Roland Beleri, i cili është sekretar i Degës së PDR Tiranë, shprehen se ata i kanë gjetur të gjitha lehtësirat nga partia e tyre për të organizuar trainime dhe ata kanë qenë gjithmonë të integruar si trainues në të gjitha trainimet që ka zhvilluar PDR. Edhe pjesmarrësi i Partisë Lëvizja e Legalitetit në programin e NDI, z. Blerim Kamberi (foto majtas), i cili ushtron funksionin e sekretarit për median në parti, shprehet se ai i ka gjetur të gjitha kushtet e favorshme në partinë e tij për të shpërndarë njohuritë e marra nga ky program tek kolegët e tij.



## Gruaja - Minorancë e dhunuar nga mendësia kanunore e lidërshiptit burrë

Nga Arta Sakja

10 kandidatë për kryetare komune, 3 kandidatë për kryetare minibashkie, 1 kandidatë për kryetare bashkie (Roskovec) — këto janë mundësitë që ofron Partia Socialiste për gruan në këtë proces zgjedhor, ndërsa Partia Demokratike fton vetëm 3 gra të kandidojnë për postin e kryetares së komunës, njëra prej të cilave u tërhoq vetëm pak ditë pasi nisi betejën elektorale... Vetëm 500 gra, kandidatë për këshilltare komune e bashkie në të gjithë Shqipërinë janë kandiduar nga të gjitha forcat politike, shpesh të renditura në zonat 'e humbjes'.

Evolucionet në Shqipëri janë gjithmonë të ngadalta, dëshmia më e bukur për këtë mbetet mbizgjatja e tranzicionit politik, subjekt dhe objekt i të cilit mbeten qytetarët shqiptarë të angazhuar ose jo në politikë. Por nëse të paangazhuarit në politikë mund t'i

fajësosh për zell të ngurtësuar politik ose mospërgjegjësi të theksuar qytetare në momentin e hedhjes ose jo të votës, të angazhuarit në politikë duhet t'i fajësojmë edhe për mosrespektimin e balancës gjinore, një parametër që vonon integrimin tonë euroatlantik dhe që nuk mund të konsiderohet më si luks teorik.

Gjatë fazës së parë të projektit "Të rrisim rolin e gruas në vendimmarrje dhe të përmirësojmë aftësitë e saj drejtuese", 12 lektore — studente të NDI ishin moderatore në përballjen e grave drejtuese të kampeve të ndryshëm të politikës, përballje që reflektoi qytetari, inteligjencë, mirëkuptim politik. Në këto seminare jo vetëm u konstatuan qetësisht fenomenet, por dhe u paraqitën alternativat për t'i zgjidhur ato. Nga to, më e spikatura do të ishte padyshim mosqenia zë në

politikën shqiptare të femrës, që nis me mosqenien zë real të grave që drejtojnë në politikë, gjë që rezonohet deri në nivelet zbritëse në bazë.

Për këtë qëllim një strategji e tërë kombëtare duhet të marrë udhë për të lançuar realisht potencialet intelektuale të gruas në politikën shqiptare të drejtuar nga mendësitë kanunore të jugut dhe të veriut. Që të mos kemi një tjetër përfaqësim të turpshëm të gruas si ky i zgjedhjeve të fundit vendore, evolucionin duhet të nisë nga një revolucion në sistemin partiak të përfaqësimit, me ndryshimin e statuteve partiake, ku vendosja e kuotës për përfaqësimin e femrës është vendosur vetëm për sistemin e brendshëm drejtues të partisë, dhe jo për sistemin qeverisës dhe atë legjislativ. Për të mos patur ndoshta fare këtë kuotë që për

grupe të ndryshëm përfaqëson herë domosdoshmëri herë zinxhrr politik të kotë, Shqipërisë dhe politikës së saj, përfaqësimit real të gruas dhe burrit në politikë i duhet një sistem votimi që përdoret sot gjerësisht në parti të majta, të qendrës dhe të djathta në Evropë e më gjerë. Ai njihet si "Një anëtar një votë."





# Opinione:

## Domosdoshmëria e pjesmarrjes rinore në politikë



**Elvis Mataj, PS**

Është bërë e zakonshme që në ambiente politike, publike, debate, diskutime e më gjerë, në politikanët e rinj përballlemi shpesh me pyetje sfiduese si: Ku është roli i politikanëve të rinj në zhvillimet e reja politike në vend? apo: Pse në shumë parti politike, gjithmonë e më pak të rinj politikanë afirmohen në struktura drejtuese? Mendoj që ka disa arsye:

Së pari: Drejtuesit kryesorë të partive politike, integrimin e politikanëve të rinj e shohin si një rrezik të ardhmënisë së karrierës së tyre politike. Duke qenë se brezi i ri ka më shumë shanse e mundësi për të pasur një arsimim më cilësor, një nivel informimi shumëdimensional dhe një vizion integriteti më të gjerë, egzistojnë gjasat që shumë shpejt ata të bëhen konkurrues në politikë, duke ofruar koncepte të reja e duke qenë më larg frymës konfliktuale që karakterizon politikën shqiptare. Pra, politikanët e "vjetër" shërbejnë si barrierë për politikanët e "rinj".

Së dyti :Ushtrimi i artit të politikës është një proces i vështirë e i gjatë, i cili kërkon shumë punë, përkushtim e sakrificë. Për të rinjtë është sfidues një investim afatgjatë siç është politika, ku do t'iu duhet të lënë mënjane impenjimet e moshës dhe ambientit ku jetojnë. Pra, është e vështirë të rekrutosh të rinj në politikë, pasi ata e shohin akoma politikën si një treg pa rregulla loje.

Së treti: Politika shqiptare ka nevojë për "politikanë të rinj" e jo për "të rinj politikanë". Akoma në Shqipëri nuk ka institucione arsimore, studimore e shkencore, që të fokusohen në gjenerimin e një brezi politikanësh të rinj. Përveç programit tepër serioz e ambicioz të Institutit Demokratik Amerikan, shumë pak insiativa afatgjata plotësojnë modulin e trainimeve politike.

Gjithsesi, eksperiencia e këtyre 13 viteve demokraci ka treguar që, në situata delikate e të rëndësishme, politika është mbështetur tek vizioni i të rinjve. Tepër domethënës ka qenë drejtimi i Qeverisë nga dy politikanë të rinj, si Illir Meta e Pandeli Majko, pas krizës së vitit 1998, të cilët drejtuan me mençuri dhe zgjuarsiti situata tepër të vështira dhe historike.

Pra, shembujt nuk mungojnë. Por, që t'i kthejmë këto shembujt në disa dhjetëra, duhet që të mendohet seriozisht për krijimin dhe funksionimin e një brezi politikanësh të rinj, pasi një Shqipëri që kërkon të arrijë standarte bashkohore, duhet të drejtohet nga politikanë vizionarë.



**Agron Sula, PD**

Pjesmarrja e rinisë shqiptare në jetën politike është shumë e rëndësishme por për momentin nuk është në nivelin e duhur. Përqindja e të rinjve në postet drejtuese dhe vendimmarrëse në Shqipëri është shumë e ulët, çka do të thotë që ata nuk e kanë mundësinë të shprehin interesat e tyre, të thonë mendimet e tyre dhe të ndjehen pjesë e ndryshimeve që po kalon vendi. Shumica e të rinjve, janë përpjekur të emigrojnë apo të studiojnë jashtë shtetit me shpresën se atje do t'iu krijohen më shumë hapësira dhe mundësi për të gjetur vetveten. Megjithë dëshirën e mirë për të bërë diçka në vendin e tyre, për shkak të alternativave të pakta që ata gjejnë në Shqipëri, zgjedhin vendet perëndimore, Amerikën, Kanadanë. Emigrimi dhe kushtet politike në Shqipëri kanë bërë që ata të mos jenë shumë aktivë në jetën politike Shqiptare.

Pjesmarrja e rinisë në jetën politike do të sillte ndryshime pozitive, pasi të rinjtë gjithmonë mbartin vlera dhe ide të reja. Pjesmarrja e tyre do të ndryshonte mënyrën e të punuarit, të vepruarit dhe të komunikimit midis brezave. Rinia e sotme është rritur në kushte shumë më të ndryshme nga ajo paraardhëse, gjë që ka ndikuar shumë në formimin dhe mënyrën e gjykimit. Nëse të rinjtë do të ishin pjesmarrës, ata do të ndihmonin në zbutjen e kontradiktave midis brezave që jetojnë në Shqipëri dhe në një qeverisje më demokratike. Mungesa e shembujve pozitivë (mungesa e lidershit) ka bërë që të rinjtë të mos kenë një pikë orjentimi dhe një shembull frymëzues.

Në mënyrë që të rinjtë shqiptarë të bëhen pjesë e politikës, ata duhet të nxiten, duhet të ndjehen të sigurtë dhe të përkrahur nga partitë politike, nga rrethet apo klubet shoqërorë, por veçanërisht nga shoqëria civile.

## Opinione për NDI



**Mark Lleshi**

**Programi më i ri i NDI është një shkollë e madhe për të ardhmen tonë politike.**



**Altin Qoshja**

**Rëndësinë e këtij programi e kemi parë edhe tani, gjatë kësaj fushate elektorale, ku eksperiencia e fituar ka qenë shumë efektive në punën tonë.**



**Xhuljeta Jaho**

**Bashkëpunimi ndërpartiak është ajo që i mungon politikës shqiptare. Këtë, në mënyrë bashkëkohore, po na e jep NDI nëpërmjet programit të saj.**

# Demokracia Fillon Që Në Shtëpi- Përse Partive Politike Shqiptare I'u Nevojitet Demokratizimi i Brendshëm

Nga Dan Redford



1991-shi ishte viti kur Shqipëria u çlirua prej makthit të regjimit komunist për të kaluar në një situatë të re ku pjesëmarrja qytetare në politikë inkurajohet përmes mjeteve të tilla siç janë partitë politike. Dhe vetëm në dymbëdhjetë vjet këto parti kanë bërë të mundur krijimin e një kulture e cila pranon gjerësisht qeverisjen kushtetuese si mënyrën më të mirë për përparimin e Shqipërisë. Ndërsa mund të ketë ende vend për diskutim në lidhje me hollësitë e politikave që ndiqen, dhe ndërsa zgjedhjet lokale nuk

kaluan fare pa incidente tani është e vërtetë të thuhet se Shqipëria nuk është më toka e fundit të viteve '90. Kutia e votimit sigurisht ka dalë fituese përballë plumbave dhe bombave.

Padyshim, shumica e asaj çka është arritur deri tani ka ardhur si rezultat i konsensusit që politikanët shqiptarë kanë arritur në një kohë krahasimisht të shkurtër — mos harroni se Britanisë i'u deshën mbi tre shekuj për të zhvilluar sistemin qeverisës që ne njohim sot. Duke thënë të gjitha këto, unë dyshoj që Shqipëria të dëshirojë të presë edhe treqind vjet të tjera për të arritur pjesën tjetër të europës perëndimore. Pra është e qartë që ka shumë punë për t'u bërë nëse Shqipëria dëshiron të prekë prosperitetin ekonomik dhe politik.

Herë pas here duket qartë që shumica e partive politike ende priren që të influencohen fuqishëm nga grupe shumë të vegjël individësh të cilët duket se i mbajnë pozicionet e tyre duke i rezistuar vullnetit demokratik të anëtarëve të thjeshtë të partisë. Por nëse partitë politike janë forca lëvizëse e cila synon mbështetjen e zbatimit të reformave të domosdoshme për ta nxjerrë këtë vend nga kriza e tanishme, atëherë këto parti duhet të adoptojnë një mentalitet më demokratik në vetë organizmat e tyre në mënyrë që një numër sa më maksimal idesh të përfshihet në debatin politik. Kjo do të sillte si përfitim një demonstrim përballë qytetarëve se partitë politike e praktikojnë atë çka ato predikojnë.

Mbi të gjitha, një parti e cila nuk e praktikon llogaridhënien në organizatën e saj ka pak gjasa që të bëjë diçka më të mirë nëse do të administronte qeverisjen. Kështu që Instituti Kombëtar Demokratik për Çështjet Ndërkombëtare<sup>1</sup> (NDI) do të mbështeste idenë që partitë politike të fillonin procesin e adoptimit të procedurave të thjeshta në statutet e tyre të cilat do të zgjeronin të drejtat e të votuarit tek të gjithë anëtarët. Në përzgjedhjen e kandidatëve dhe të udhëheqësve të partive, vota e çdo anëtari duhet të ketë vlerë të njëjtë — që nga Kryetari i Partisë deri tek anëtari më i thjeshtë — një sistem ky që në Europën Perëndimore njihet si — 'një anëtar një votë'.

Momentalisht mbisundon një nivel krahasimisht i ulët interesi dhe pjesëmarrjeje mes anëtarëve të thjeshtë të partive dhe kjo vjen saktësisht prej faktit se vetëm një pakicë prej tyre kanë të drejtën për të votuar dhe për të ushtruar ndikim në partitë e tyre. Prezantimi gradual i 'një anëtar një votë' pa dyshim që do të rrisë nivelin e ulët momental të interesit të anëtarëve të thjeshtë të partisë pasi ata do të ndajnë se pikpamjet e tyre kanë vlerë. Kjo gjë to të rrisë gjithashtu edhe numrin e atyre që do të konkurrojnë për një pozicion të zgjedhuri qoftë brenda partisë qoftë në nivele zgjedhjesh për qeverisje qendrore apo lokale.

Për shkak të këtij niveli të lartë apatie mes 'ushtarëve të terrenit' s'ka pse

të duket e habitshme që shumë qytetarë janë shndërruar plotësisht në njerëz të deziluzionuar dhe të lodhur me procesin politik. Në fund të fundit, nëse ambasadorët e partisë në nivelin më lokal nuk mund të frymëzohen me partinë e tyre, në çfarë mënyrë do të mundën ata të frymëzojnë votuesit e zakonshëm që t'u japin votën ditën e zgjedhjeve?

Përvoja tregon se pa ndjesinë e mbushjes me pushtet që anëtarët e partisë e marrin nëpërmjet votimit për çështjet e partisë, anëtarësia e partisë do të varfërohet dhe partia në fund do të vdesë. Nga ana tjetër është pikërisht kjo arsyeja përse një parti do të forcohet akoma më tej nëse ajo do të lejonte mundësisë për pjesëmarrje tek të gjithë anëtarët. Përse supozohet se zgjerimi i të drejtës për të votuar do të bënte që delegatët ekzistues të partisë të mos ndiheshin më pjesë e procesit? Duke zgjeruar përfshirjen, shumë më tepër anëtarë do të ndihen pjesë e organizimit dhe do të jenë më të prirur për të vepruar si avokatë publikë kundrejt qytetarëve në një mënyrë më bindëse dhe në këtë mënyrë do të reduktonin nivelin momental të indiferencës ndaj votimit.

Një arsye se përse votuesit i shikojnë partitë politike me një mëdyshje të këllillë është se ato konceptohen, sado në një mënyrë jokorrekte, si "paraixa të sigurt" për interesat e ngushta të një pakice të përzgjedhur. Argumenti se nuk ka anëtarë të tjerë me aftësitë e domosdoshme udhëheqëse që do të mund ishin të aftë të zinin vendet e tyre, thjesht nuk mund të pijë më ujë. Nëse partitë politike shqiptare dëshirojnë të kenë organizime të suksesshme që do t'i drejtoheshin votuesve, atëherë ato duhet të theksojnë me forcë konceptin se ato nuk janë vilajetet personale të një pakice të përzgjedhur. Dhe kjo mund të bëhet fare lehtë duke i'u lejuar anëtarëve të kandidojnë për pozicione udhëheqëse ose të ushtrojnë votën e tyre për të zgjedhur se cili do të jetë udhëheqësi i tyre. Në një vend si Britania, janë anëtarët e partisë që kanë pushtet sovran dhe zyrtarët e zgjedhur të partisë veprojnë si kujdestarë të përkohshëm të interesave të anëtarëve të thjeshtë.

Megjithë këtë, ende argumentohet se demokratizimi më i gjerë i partisë nuk do të rrisë pjesëmarrjen e anëtarëve të thjeshtë në votim. Sidoqoftë, nëse një parti politike e quan veten një organizim demokratik, atëherë me siguri ajo nuk mund t'u mohojë anëtarëve të drejtën për të votuar, thjesht bazuar mbi hipotezën se nuk do të votojë një numër i mjaftueshëm anëtarësh. Kjo shërben vetëm për për t'u dhënë votuesve përshtypjen se ata që kundërshtojnë ndryshimin janë vetëm ata që do të humbasin më shumë nëse kjo reformë do të zbatohet. Në fakt, mes qytetarëve ekzistojnë një pikpamje me bazë të gjerë për politikanët e zgjedhur prej tyre e cila thotë se ata nuk janë në 'lartësinë e detyrës'. Në fakt, kjo nuk do të ishte e habitshme për faktin se mekanizmat aktualë të cilat zbatohen nga partitë politike për të përzgjedhur zyrtarët dhe kandidatët e tyre priren për të krijuar situata ku zgjedhjet fitohen nëpërmjet ndikimeve "të mbuluara" të "rregulluesve" të lartë të partisë dhe jo gjithmonë bazuar mbi meritat. Nëse anëtarësia e gjerë do të kishte të drejtën e votës, këto lloj ndikimesh të vogla por të dëmshme pa dyshim që do të veniteshin.

Një parim bazë në çdo demokraci moderne është që ata që zgjidhen në një post publik bëhen plotësisht llogaridhënës kundrejt atyre të cilët i kanë zgjedhur në këtë post. Duke vazhduar procesin e reformës së brendshme të partive, 'një anëtar një votë' mund të fillojë procesin e bërjes së partive politike llogaridhënese kundrejt votuesve. Momentalisht, partitë politike kanë një strukturë në të cilën zyrtarët e partisë janë përgjegjës vetëm kundrejt delegatëve prej të cilëve zgjidhen dhe jo ndaj anëtarëve të thjeshtë apo elektoratit në përgjithësi. Sidoqoftë, të gjitha partitë politike, dhe jo vetëm në Shqipëri, kanë nevojë të kenë djeni dhe të kuptojnë se çfarë ndodh nëpër bashki dhe komuna. Me këtë shkëputje të dukshme që ndihet në Shqipëri nuk është e habitshme që qytetarët të thonë se politikanët shfaqen si të palidhur me realitetin.



Në vende ku partitë politike nuk operojnë nëpërmjet vendmarrjes së brendshme demokratike, nuk ka qenë e pazakontë që fraksione politikë të rrëmbejnë organizmat e vendmarrjes duke futur nëpër to aktivistët e tyre. Kjo taktikë, jo vetëm që shpesh sjell si rezultat që politikat e partisë të orjentohej nga pikpamjet e një pakice, por gjithashtu ajo nuk ka gjasa që të mundësojë reflektimin e opinioneve të anëtarësisë së gjerë, dhe në këtë mënyrë mund të vërë në rrezik pozicionin elektoral të një partie. Votuesit mund t'i konceptojnë këto parti si të pozicionuara në periferi të debatit qendror politik. Brenda Partisë Laboriste Britanike<sup>2</sup> mes viteve 1975 — 1983, një pakicë Trockiste mundi të manipulonte procedurat e brendshme demokratike dhe në këtë mënyrë ishte totalisht e aftë për të anashkaluar pikëpamjet e anëtarëve të zakonshëm të partisë. Pasoja e përmbledhëse e kësaj nuk mund të përshkruhet më ashpër — Partia Laboriste doli në opozitë për gati një çerek shekulli dhe gati sa nuk perëndoi njëherë e përgjithmonë. Kjo është një histori e dobishme prej nga ku të gjitha partitë politike duhet të nxjerrin mësim.



Në fakt, larg prej vënies në rrezik të postit të një udhëheqësi partie adoptimi i 'një anëtar një votë' më tepër do të ndihmonte forcimin e autoritetit të tij apo të saj. Nëse një politikan fiton, psh. një zgjedhje për udhëheqës partie pas një votimi të përgjithshëm të të gjithë anëtarësisë, ai/ajo do të kenë një mandat udhëheqjeje të bazuar në mbështetjen e anëtarit të thjeshtë. Kjo do t'i pajiste ata me besimin dhe me forcën për të çuar përpara premtimet e platformës së tyre — duke qënë të vetëdijshëm se ata komandojnë duke patur mbështetjen e përgjithshme të partisë. Për gjysëm shekulli Partia Laboriste Britanike u akuzua prej kritikëve të saj se ishte shumë dhënë ndaj orientimit shtetëror. Në 1994 Tony Blair organizoi një votim të llojit 'një anëtar një votë' në lidhje me këtë çështje dhe mori një mandat të gjerë nga anëtarët e partisë për të ndryshuar ideologjinë e partisë. Pra 'një anëtar një votë' ndihmoi që t'i bënte kritikët e partisë të heshtnin dhe në këtë mënyrë ndikoi në krijimin e një pejzazhi të ri politik të favorshëm për Partinë Laboriste Britanike i cili mund të ndihet edhe në ditët e sotme.

Duke qënë se po flasim për krijimin e një pejzazhi të ri politik, ju mund të pyesni se çfarë ka bërë organizata ime për të ndihmuar në përmirësimin e situatës. NDI ka punuar në Shqipëri që prej 1991 duke ofruar training profesional për të mbështetur si shoqërinë civile ashtu edhe partitë politike. Në fund të 2002 NDI nisi një program trainimi mbi menaxhimin politik i cili synon të zhvillojë akoma më tej aftësitë profesionale të politikanëve të orjentuar drejt reformave si dhe të ndihmojë forcat politike për të ndërtuar organizata të strukturuar demokratikisht. Qëllimi ynë gjatë gjithë kohës ka qenë që të nxisim politikanët që të bëhen llogaridhënës dhe të përgjegjshëm përballë nevojave të qytetarëve. Politikanëve i'u nevojitet të dinë se të zgjidhesh do të thotë që të zbatosh politika dhe programe të cilat janë të rëndësishme për votuesin që të ka zgjedhur. Kjo është edhe arsyeja përse ne kemi zhvilluar një seri pasditesh-diskutimi ndërmjet qytetarëve dhe politikanëve. NDI do të qëndrojë e vendosur për t'i sjellë sërish së bashku qytetarët dhe politikanët dhe gjithashtu do mbështesë partitë politike në përpjekjet e tyre për të reformuar vendmarrjen e tyre të brendshme ku çështja 'një anëtar një votë' do të ishte vetëm njëri prej aspekteve.

NDI nuk mund t'a arrijë këtë objektiv të lartë e vetme sado përpjekje të mëdha që të bëjë. Kjo është pikërisht arsyeja përse NDI mbështet idenë që vetë partitë politike të njihnin një sistem të tipit 'një anëtar një votë'. Ky sistem është ndërtuar në mënyrë të tillë që të rrisë interesin e votuesit dhe pjesmarrjen publike në politikë duke i bërë partitë më të hapura ndaj ideve të reja qoftë të anëtarëve ashtu edhe të votuesve, të cilat më pas mund të sjellin ndryshime pozitive për sa i përket platformave politike dhe mënyrave me anë të të cilave mund të përzgjidhen udhëheqësit dhe kandidatët. Është një metodë e përdorur me sukses nga partitë në Britani dhe gjithë Europën Perëndimore. Nisur nga dëshira e këtij vendi për të qenë pjesë e 'familjes europiane' ndoshta këto janë shembuj të mirë për t'u ndjekur. NDI është plotësisht e gatshme dhe plot dëshirë që të të mbështesë këtë pjesë të rëndësishme të zhvillimit të demokracisë në Shqipëri.

## Opinione për NDI



**Xhuljeta Kërtusha**  
Ky program i'u ofron politikanëve të rinj krijimin e një përvoje praktike bazuar në teknika politike tashmë të eksperimentuara me sukses në politikën Perëndimore.



**Saimir Dashi**  
Prania jonë në këtë program është një impenjim që na bën të krijojmë një vizion për t'i rikthyer shqiptarëve besimin tek politika përmes një pune të pandërprerë dhe të prekshme.



**Roland Bejko**  
Me këtë program NDI po ndihmon politikën shqiptare me politikanë të rinj të kualifikuar, të aftë për të menaxhuar fushata elektorale, të gatshëm për të kandiduar për të gjitha përgjegjësitë politike.

## Kush janë njerëzit e NDI

### Bordi i Drejtorëve të Institutit Kombëtar Demokratik

**Madeleine K. Albright**

Kryetare

**Kenneth D. Wollack**

President

**Robert Benjamin**

Drejtor Rajonal

**Catherine Messina Pajic**

Zëvendës Drejtoreshë Rajonale

**William Hayden**

Përgjegjës i Lartë i Programit

**Megan Unangst**

Asistente e Programit

### Stafi i Programit të Zhvillimit të Partive Politike, NDI - Shqipëri

**Jennifer L. Butz**

Drejtoreshë e Zyrës Vendore dhe e

Programit Forumi Civil

**Dan Redford**

Drejtor i Programit të Partive Politike

**Guri Daco**

Asistent i Programit të Partive Politike

**Enri Prodani**

Konsulent i Programit të Partive Politike

**Kryeredaktor**  
Guri Daco  
**Redaktorë**  
Alma Lahe, Edvin Zoto, Enri Prodani



**Bordi Redaksional**  
Arben Qirako, Roland Bejko, Antoneta Malja,  
Reis Mullita, Artan Çela, Erleva Bisha,  
Alban Zusi, Taqiant Balla

**Ky publikim u bë i mundur nga mbështetja e USAID**



**POLITIKANI I RI**

REVISTA E PËRTREMUAJSHME E PROGRAMIT MBI  
MENAXHIMIN POLITIK TË NDI

www.ndi.org

e-mail: zhup@ndialbania.org

Nr.2 Nëntor 2003